



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

13 Nr. Zyrtar – 2026
Me datë: 15.04.2026

-XIII- Nr. i prot. 90 Më Dt. 15.04.2026
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 1046 të datës 05.03.2026, dhe në mbështetje të vendimit me Nr. Prot.7115 të datës 18.03.2026, për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në kulturë nga DKRS-ja për vitin 2026, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ndarjen e shumës financiare sipas projekteve për OJQ-të që i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret për subvencionim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, sipas thirrjes publike për aplikim e subvencionim të OJQ-ve në komunën e Rahovecit.
2. Bashkëngjitur me këtë vendim është lista e përfituesve të subvencioneve në sektorin e kulturës.

Lista e OJQ-ve përfituese të subvencioneve në sektorin e kulturës

Organizata e Veteranëve Të UÇK-së	Organizimi i manifestimeve përkujtimore për dëshmorët
Art Sudio	Simpoziumi ndërkombëtar i Artit Edicioni i 25-të
Fondi Për Edukim Dhe Trashëgimi	Festivali ndërkombëtar i poezisë "Poezia dhe Vera"
Sh.K.A Bajram Curri	Ta kultivojmë kulturën shqipe dhe të përgatimis rininë
Qendra Kulturore Jehona Anadrinit	Festivali folklorik "Anadrinia Jehon" 2026 edicioni i 25-të
Eksodi 99	Shënimi i 27 -vjetorit të eksodit 99
Klubi Letrar Xhevdet Bajraj	Festivali poetik "Muzat e vreshtave"
Sh.K.A Rahoveci	Talentet e rinjë krijojnë festivale kulturore
Shoqata E Kitaristave Vihuela	N'konak të Rahovecit na bashkon kënga shqipe edicioni i 8-të
Shoqata Tradita Anadrinit	Ruajtja dhe kultivimi i vlerave kombëtare
Muzeu Anadrini	Promovimi i trashëgimisë kulturore të Rahovecit
Shshkk	Ajkë dhe mjaltë
Forumi Anadrini	Festivali Fardi Fest 2026

ARSYETIM

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, me Nr.prot.7115, të datës 18.03.2026 , është formuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës për vitin 2026.

Komisioni ka bërë hapjen dhe vlerësimin e aplikacioneve të cilët kanë konkuruar për subvencione të DKRS-së, për vitin 2026 duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim.

Nga gjithsej katërmbëdhjetë (14) aplikacione të pranuar, komisioni ka vlerësuar se kriteret për subvencionim i kanë përmbushur (13) prej tyre, ndërsa një (1) është refuzuar për mungesë dokumentacioni.

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me OJQ-të, përfituese të subvencioneve komunale.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e rinisë dhe sportit .

Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës.

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1. Muharem Morina – Kryesues - _____
2. Blerta Hasani – Anëtare - _____
3. Feriz Thaqi - Anëtar - _____
4. Izet Morina - Anëtar - _____
5. Roland Mullavda -- Anëtar _____

